

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRÇJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"AIN Travel Tours" SHPK.**

Soç, në Tiranë, më 27.06.2022, unë Adi Hoxha, lindur më 10.04.1992 në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga "Zihni Sinoimeri", Ndërtesa Nr.26, Hyrja Nr.1, Njësia Administrative Nr.2, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal J20410072A, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues i vetëm dhe deklaroj se kam përfilluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "AIN Travel Tours" SHPK.

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare "AIN Travel Tours" SHPK, e cila do të nënshkruhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISE**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare "AIN Travel Tours" SHPK do të jetë në adresën: "Rruga e Durrësit", Pallati Nr.204, Hyrja 2, Apartamenti 24, Tiranë.

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**OBJEKTI I SHOQËRISE**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt: Operator turistik. Agjenci turistike dhe udhëtimesh. Shitje dhe blerje biletash avionike, trageti, autobuzi. Shitje dhe blerje të paketave turistike me grupe të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Makina me qira, siguracion shëndeti në udhëtim. Organizime turesh Brenda dhe jashtë vendit. Pushime dhe udhëtime me korpera. Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit për vete dhe të tretë.

Shoqëria mund të nënshkruajë kontrata apo të jetë palë kontraktuese për marrëveshjet civile apo tregtare me institucione shtetërore, publike apo private në lidhje me kryerjen e shërbimeve sipas objektit të kontratës apo të marrë pjesë në tendera, në marrëdhënie civile, tregtare brenda dhe jashtë Shqipërisë për interesat e shoqërisë. Shoqëri mund të marrë pjesë personalisht apo të jetë palë në marrëdhënie kontraktore me shoqëri të tjera, si dhe ushtrimin e çdo veprimtarie të ligjshme.

Shoqëria mund të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me shoqëri të tjera që operojnë në fusha të ndryshme të së drejtës civile e tregtare shqiptare, të ketë të drejtën e shitblerjes së kuotave të ortakëve apo ortakut të vetëm të një shoqërie tjetër, të ofrojë garanci të çdo lloji që parashikon ligji për aktivitetin e ligjshëm të çdo subjekti fizik apo juridik privat.

**Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.



## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 500,000 (Pesëqindmijë lekë), kontribut i ortakut të vetëm, i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

## DREJTIMI I SHOQËRISË

### Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "AIN Travel Tours" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Adi Hoxha për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gjkon të nevojshme.

### Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

### Neni 10

Shoqëria tregtare "AIN Travel Tours" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

### Neni 11

Shoqëria tregtare "AIN Travel Tours" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Këtë dokument, unë ortaku i vetëm i shoqërisë, me të drejta dhe kompetenca të plota e hartova dhe bie dakort pa asnjë rezervë për ta nënshkruar.

## THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"AIN Travel Tours" SHPK

ORTAKU I VETËM

Adi Hoxha

